



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E APELIT  
TIRANË**

Nr. 3480 Akti

Nr. 167 Vendimi

*Arsyetim i përmbledhur i vendimit gjyqësor*

Gjykata e Apelit Tiranë, e përbërë nga :

**Kryesuese : Edlira PETRI  
Anëtar : Genti SHALA  
Anëtare : Elbana LLURI**

sot më datë 21.02.2022, përfundoi gjykimin e zhvilluar në seancë gjyqësore me dyer të hapura, të çështjes penale nr. 3480 Akti, që i përket:

**KËRKUESE : Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, e përfaqësuar në apel nga prokurore znj. Arta Marku

**TË PANDEHUR** : 1- **V.K.**, i mbrojtur në gjykim nga av. Gëzime Buci, e caktuar kryesisht nga gjykata, si dhe nga mbrojtësi i zgjedhur me deklaram av. Arbër Hoxha.  
2- **Rr.H.**, i mbrojtur nga av. Antoneta Lala, e caktuar kryesisht nga gjykata, si dhe nga av. Arbër Hoxha, sipas deklaramit në seancë gjyqësore.

**TË AKUZUAR** : Për kryerjen e veprave penale të “Vjedhjes me pasojë vdekjen”, të kryer në bashkëpunim dhe “mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe të municionit”, të parashikuara nga nenet 141-25 dhe 278, paragrafi i parë të Kodit Penal.

**VIKTIMA** : 1-**R.B.**, e përfaqësuar nga av. Idajet Beqiri dhe av. Glerida Muca;  
2-**E.B.**, e përfaqësuar në gjykim nga av. Idajet Beqiri dhe av. Glerida Muca.

Në përfundim të gjykimit të çështjes në shkallë të parë, *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin nr. 1020, datë 19.04.2019*, ka vendosur:

- “Deklarimin fajtor të të pandehurit **V.K** për kryerjen e veprës penale të “**Vjedhjes me pasojë vdekjen**”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 141 e 25 të K.Penal dhe në bazë të këtyre dispozitave e dënon **atë me burgim të përjetshëm**.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit **V.K** për kryerjen e veprës penale të “**Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe të municionit**”, të parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite e dënon **atë me 7**

**(shtatë) vjet burgim.**

- Në aplikim të nenit 55 të K.Penal, në bashkim të dënimeve, i pandehuri **V.K** dënohet me **burgim të përjetshëm**.
- Vuajtja e dënimit me burgim për të pandehurin **V.K** fillon nga dita e ndalimit të tij në funksion të këtij procedimi dhe të kryhet në një burg të sigurisë së lartë.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Rr.H** për kryerjen e veprës penale të **“Vjedhjes me pasojë vdekjen”**, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 141 e 25 të K.Penal dhe në bazë të këtyre dispozitave e dënon **atë me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim**.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Rr.H** për kryerjen e veprës penale të **“Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe të municionit”**, të parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite e dënon **atë me 4 (katër) vjet burgim**.
- Në aplikim të nenit 55 të K.Penal, në bashkim të dënimeve, i pandehuri **Rr.H** dënohet **26 (njëzet e gjashtë) vjet burgim**.
- Vuajtja e dënimit me burgim për të pandehurin **Rr.H** fillon nga dita e ndalimit të tij në funksion të këtij procedimi dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
- Në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale provat materiale disponohen si më poshtë vijon:
  - një aparat celular i markës “S.....”, me ngjyrë gri e të bardhë, bashkë me kartën celulare me nr. 068....., veshjet pantallona dhe një automjet i markës “V.....” me targa AA.....
  - ..... me dokumentacionin shoqëruar, të sekuestruara në fazën e hetimit, t’i kthehen familjarëve të të pandehurit Rr.H.
  - veshjet pantallona të sekuestruara t’i kthehen familjarëve të të pandehurit V.K,
  - katër CD me pamje filmike dhe një DVR (digital Video Recorder ) të sekuestruara në fazën e hetimit, të mbeten pjesë e dosjes gjyqësore.
- Shpenzimet procedurale hetimore dhe ato gjyqësore të parapaguara nga shteti lihen në ngarkim solidar të të pandehurve V.K dhe Rr.H.

Gjykimi në apel

Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kanë paraqitur ankim :

**-I pandehuri V.K,** duke kërkuar :

*“Ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe kualifikimin e saj nga “Vjedhje me pasojë vdekjen”, në “Vjedhje me armë” dhe për pasojë një dënim më të butë.*

**-I pandehuri Rr.H,** duke kërkuar :

-Ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga ‘Vjedhje me pasojë vdekjen’, parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, në “Vjedhje me armë”, parashikuar nga neni 140 I Kodit Penal.

-Prishje e vendimit nr. 1020 datë 19.04.2019 dhe deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Rr. H** për veprën penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe të municionit” të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit .Penal.

-Ndryshimin e vendimit nr. 1020 datë 19.04.2019 dhe ulja e masës së dënimit në kufirin minimal të parashikuar nga ligji, dhe zbatim më tej i nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale.

**-Viktima R.B,** duke kërkuar :

- Ndryshimin e vendimit nr. 1020 datë 19.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me dënimin e të pandehurit **Rr.H**, nga dënimi me 26 vite burgim në burgim të përjetshëm.

### *Vlerësimi i përmbledhur i Gjykatës së Apelit*

Pretendimet e ankuesve dhe kërkimet e tyre para gjykatës së apelit, sikurse parashtrohet më sipër, konsistojnë në cilësimin ligjor të faktit penal, si dhe në masën e dënimit që u caktua nga gjykata e shkallës së parë.

Në gjykimin në apel, të pandehurit/ankuesit bënë deklaramë që jo vetëm nuk përkonin dhe as synonin të mbështesnin ankimet respektive, por përkundrazi ato përkeqësonin pozitën e tyre. Të pandehurit deklaruan se në vendin e ngjarjes nuk shkuan me synimin për të vjedhur, por për të vrarë viktimën e veprës penale, pasi ishin porositur nga shtetasi **A. Z.**, kundrejt premtimit për tu paguar me shumën prej 30,000 Euro.

Gjykata e apelit, e ndodhur në këtë situatë procedurale, kur

- praktikisht ankuesit nuk po mbroheshin për akuzat e ngritura ndaj tyre dhe për të cilat ishin gjykuar,
- ata po “shfrytëzonin” seancën gjyqësore në apel për të deklaruar fakte, që nuk kishin rezultuar nga hetimet e kryera për këtë ngjarje dhe që rrjedhimisht nuk ishin objekt akuze;
- kur këto fakte, që deklaroheshin, lidheshin qoftë edhe indirekt me disa të dhëna të marra gjatë hetimit të çështjes;

në seancën gjyqësore të datës 09.11.2021, vendosi të ndërpresë gjykimin dhe të referojë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të dhënat e mësipërme të pasqyruara në procesverbalin e seancës gjyqësore (përfshirë CD audio). Ky vendim i ndërmjetëm i gjykatës së apelit u mor me qëllim që të gjithë pjesëmarrësit në proces, përfshirë prokuroren e apelit, të vlerësojnë situatën dhe të paraqesin kërkimet e tyre eventuale në këtë gjykim, në dobi të dhënies së drejtësisë, si dhe të garantimit të procesit të rregullt gjyqësor.

Në vijim të procesit, megjithëse u shtynë disa seanca gjyqësore, as gjykata e apelit dhe as prokurorja e apelit, sipas deklaramit të saj, nuk morën ndonjë reagim nga prokuroria ku u referuan deklaramet. Në këto kushte, kur nga ana e prokurorisë nuk pati as ndonjë qëndrim dhe as ndonjë kërkim procedural, mbi faktet e deklaruara rishtazi, gjykata, pasi dëgjoi të gjithë pjesëmarrësit, vendosi të vijojë gjykimin në apel.

Ankuesit, nëpërmjet mbrojtësit, i kërkuan gjykatës së apelit, ri çeljen e shqyrtimit gjyqësor, me qëllim marrjen e provave që do të vërtetonin faktet e deklaruara prej tyre, si më sipër përshkruar. Në alternativë, ata kërkuan prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

I njëjti kërkim për marrjen e provave në gjykimin në apel, u paraqit edhe nga mbrojtësja e viktimave të veprës penale.

Prokurorja e apelit nuk e përkrahu kërkesën për përsëritje të hetimit gjyqësor, ndërsa në raport me ankimet, kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pasi dëgjoi qëndrimet e palëve, gjykata e apelit vuri në diskutim zgjidhjen e çështjes, duke mbajtur në konsideratë, ndër të tjera, edhe këto parime dhe rregulla të gjykimit penal :

- Gjykata ka detyrimin të sigurojë një proces të rregullt gjyqësor, përfshirë këtu të drejtën e të pandehurit për tu mbrojtur, ndaj akuzave që i drejtohen;
- Rregullat, mbi të cilat kryhen hetimet dhe zhvillohen gjykimet penale, janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjitha subjektet procedurale.
- Ndjekja penale është kompetencë e prokurorit, i cili përfaqëson në emër të shtetit akuzën para gjykatës. Një ndër kompetencat e prokurorit është edhe lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me bashkëpunëtorët e drejtësisë, në cdo fazë të procesit penal.
- Gjykata është organi që realizon dhënien e drejtësisë.
- Gjykimi në apel kufizohet nga shkaqet e ngritura në ankim, duke qenë e ndaluar me ligj që palët të parashtrojnë shkaqe tej atyre të ngritura në ankim.
- Kur ankues është i pandehuri zbatohet parimi i mos rëndimit të pozitës.
- Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në apel, kryhet gjithmonë në funksion të shkaqeve të ankimit.

Nisur nga këto rregulla procedurale, gjykata e apelit vlerësoi se në rastin në shqyrtim, në mungesë të një marrëveshjeje mes prokurorit dhe të pandehurve, si dhe të një reagimi se një marrëveshje bashkëpunimi mund të lidhej mes tyre, normat mbi të cilat zhvillohet gjykimi në apel, obligojnë gjykatën që ta vijojë atë, brenda shkaqeve të ankimeve të paraqitura nga të pandehurit.

Kërkesa e të pandehurve për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, me synimin final të vërtetimit të faktit se ngjarja kriminale ishte një vrasje me paramendim dhe jo një vjedhje me pasojë vdekjen, edhe nëse do të rezultonte kështu, nuk përkon me ankimet objekt shqyrtimi dhe do të çonte në rëndim të pozitës së të pandehurve/ankuesve.

Mbi bazën e sa më sipër, duke e gjykuar çështjen brenda shkaqeve të ankimit, si dhe duke i gjetur pretendimet e ankuesve të pabazuara në faktet dhe provat, e marra në gjykimin në shkallë të parë, gjykata e apelit arriti në përfundimin se nuk ka asnjë arsye për të ndryshuar vendimin e ankimuar.

Sa i përket ankimit të viktimave të veprës penale, gjykata e apelit vendosi të mos e pranojë atë, pasi viktima e veprës penale nuk legjitimohet të bëjë ankim ndaj vendimit përfundimtar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar edhe në nenet 428, shkronja “a” dhe 420, shkronja “a” të Kodit të Procedurës Penale

### **VENDOSI :**

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 1020, datë 19.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me ankimet e të pandehurve **Rr.H** dhe **V.K**.
- Mospranimin e ankimit të viktimës së veprës penale..

- Kundër vendimit lejohet rekurs ne Gjykatën e Lartë, brenda 45 ditëve duke filluar nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.

**Tiranë, 21.02.2022**